



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 21, datë 10.06.2021

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:  
“OBJEKT BANIMI DHE SHËRBIMI ME 11 KATE MBI TOKË DHE 2 KATE  
NËNTOKË”, LUNGOMARE, BASHKIA VLORË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjekteve zhvilluese shoqëritë “Europa Building” sh.p.k dhe “Hanxhari Group” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Objekt banimi dhe shërbimi me 11 kate mbi tokë dhe 2 kate nëntokë, Lungomare, Bashkia Vlorë”, me subjekte zhvillues shoqëritë “Europa Building” sh.p.k dhe “Hanxhari Group” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
  - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Vlorë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI


EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASHTRUKTURËS DHE ENERGJISË

**BELINDA BALLUKU**



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

**LEDIA TOTA**

